



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 119 Prot

Tiranë, më 12, 07, 2012

VENDIM Nr. 212, datë 12.07.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.07.2012, pasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit me adresë: **Lagjja Nr. 8, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës**, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës të Subjektit "**BOROVA-D**" sh.p.k.,

VENDOSI:

- I. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës të thellojë një nga sondazhet arkeologjike për t'u siguruar që është arritur shtresa sterile.
- II. Të plotësohet raporti i sondazheve arkeologjike, përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës për sheshin e ndërtimit të subjektit "**BOROVA-D**" sh.p.k, Lagjja Nr. 8, Rruga "Aleksandër Goga", zona arkeologjike "B" Durrës, me rezultatet e këtij sondimi shtesë.
- III. Relacioni me plotësimet të paraqitet për miratim në mbledhjen e radhës së KKA.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al